



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 161, Datë 12.07.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar; nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.07.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 102/5 prot., datë 09.07.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Qershor 2021” ,

Konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën e saj nr. 6465 prot., datë 26.06.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin Qershor 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF).
- FSHU sh.a. deklaroi se sasia e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për furnizimin e klientëve FMF për muajin Qershor 2021 është prokuruar vetëm në treg të parregulluar, informacioni i cili merret si komunikim zyrtar nga Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a.).
- Sipas informacionit të zhvillimit të procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria FTL sh.a. evidentohet se prokurimi i energjisë në tregun e parregulluar është kryer me procedurën e datës 03.12.2020, për periudhën kohore 01.01.2021 deri më 30.06.2021 në sasinë totale prej 8,688 MWh dhe në vlerën monetare 438,744 euro, me një çmim mesatar 50.50 euro/Mwh.
- Shoqëria FSHU sh.a. deklaroi se për muajin Qershor 2021 energjia e prokuruar vetëm në treg të parregulluar për plotësimin e nevojës për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga FMF është në sasinë 1,440 Mwh në vlerë prej 9,008,554 lekë.
- Kursi i këmbimit kur është realizuar procedura e blerjes së energjisë është kursi zyrtar i këmbimit, respektivisht 123.88 lekë/euro i datës 03.12.2020. Nga të dhënat e

publikuara në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezulton se kursi i këmbimit është i njëjtë me kursin e këmbimit të përdorur në datën kur është realizuar proceduara.

- Çmimi mesatar i ponderuar bazuar në sa më sipër rezulton 6.256 lekë/kWh.
- Kostot Administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020, në vlerën totale prej 1.79 Lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në Vendimin Nr. 212, Datë 15.12.2020 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV:** bazuar në Vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të bordit të ERE “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2021” është 1.5 lekë/kWh.
- Në zbatim të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a. si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin Qershor 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Qershor 2021				
Qershor 2021			Aplikimi FSHU sh.a.	Përlllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.256	6.256
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.19	0.19
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	6.44	6.44
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA			Leke/kWh	10.48

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës përlllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga FTL sh.a. si dhe vlerësimeve tona sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin **Qershor 2021**, të jetë **10.48 Lekë/kWh**.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 10.48 Lekë/kWh për muajin Qershor 2021.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI